



Breaking News: Vlorë – Finalizohet operacioni policor i koduar "Aleksandria"



Lajmet Operacionet

24/03/2023

Vlorë – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar "Aleksandria"

Vlorë/Finalizohet operacioni policor i koduar "Aleksandria".

Parandalohet një ngjarje e rëndë kriminale.

Sekuestrohet një armë zjarri kallashnikov.

Arrestohet në flagrancë 28-vjeçari që e mbante armën në automjetet ndërkohë që qarkullonte në qytetin e Vlorës.

Procedohen penalisht 2 shtetas (pasagjerë në automjet), për moskallëzim krimi.

Strukturat hetimore të Komisarimit të Policisë Vlorë, në bashkëpunim me shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja", në bazë të informacioneve të siguruar nga inteligjenca policore se një 28-vjeçar po qarkullonte në qytetin e Vlorës, me një automjet në të cilin mbante armë zjarri dhe se do kryente një krim të rëndë, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Aleksandria".

Në kuadër të këtij operacioni u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit:

- D. P.(A.), 28 vjeç, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit".

Gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin e tij, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 1 armë zjarri kallashnikov.

Për shkak të sekretit hetimor, duke qenë se ngjarja është në hetim, nuk jepen detaje të tjera në lidhje me motivet dhe objektivin e synuar nga i arrestuari.

Gjithashtu, në vijim të veprimeve, nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasit F. F., 17 vjeç dhe A. H., 17 vjeç, të dy banues në Vlorë, pasagjerët që udhëtonin së bashku me 28-vjeçarin, në automjetin e tij, për veprën penale "Moskallëzimi i krimi".

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për veprime të mëtejshme procedurale.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Fier/Goditi për shkak të detyrës, operatorin e një emisioni investigativ dhe i theu celularin gazetares, vihet në pranga

Gjrokastër – Finalizohet operacioni policor i koduar "Katrori" ▶